L I G J
Nr.8263, datë 15.12.1997

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË LIGJIN NR.7599, DATË 2.9.1992 "PËR KODIN DOGANOR", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8020, DATË 1.11.1995, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8148, DATË 11.9.1996

Në bazë të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 71 i ligjit nr.7599, datë 2.9.1992 "Kodi doganor I Republikës së Shqipërisë", ndryshohet si vijon:

"Shpërndarja e të ardhurave nga gjobat dhe shitja e mallrave të sekuestruara e të konfiskuara

1. Pjesa që kalon në favor të buxhetit të shtetit nga të ardhurat e gjobave dhe shitja e mallrave të sekuestruara a të konfiskuara për rastet e kundërvajtjeve ose kontrabandës, është e barabartë me 50 për qind të të ardhurave neto të tyre.

2. Pjesa tjetër prej 50 për qind kalon në favor të organeve të autorizuara, që kanë kryer veprimin dhe dokumentacionin përkatës për sekuestrimin, konfiskimin a vendosjen e gjobave në rastet e kundërvajtjeve ose të kontrabandës.

3. Kriteret dhe mënyra e shpërndarjes dhe përdorimit të shumave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin e tij nga Presidenti I Republikës.

Shpallur me dekretin nr.1969, datë 18.12.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani